



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1456/Prot.
1

Tiranë, më 13/11/2017

Lënda: Mendim lidhur me Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës.

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE

Për dijeni: **MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 24984/3, datë 01.11.2017, pasi u njohëm me përmbajtjen e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës “Mbi bashkëpunimin Doganor dhe ndihmën e ndërsjellë”, sugjerojmë si vijon:

Marrëveshja në përmbushje të qëllimit të saj, parashikon edhe përpunim të të dhënave personale, veprim në të cilin përfshihet edhe shkëmbimi/transferimi ndërkombëtar i të dhënave midis palëve nënshkruese.

Përpunimi i të dhënave kërkon reciprokisht nga palët zbatimin e disa parimeve ligjore si dhe masash garantuese me qëllim legjitimitetin e këtij procesi nga njëra anë dhe mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale nga ana tjetër.

Arritja e nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale nga palët nënshkruese është kusht i domosdoshëm në transferimin ndërkombëtar të të dhënave.

Shqipëria ka miratuar ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, i pasuar edhe me ngritjen e autoritetit të pavarur, Zyrën e Komisionerit. Komisioneri në zbatim të këtij ligji ka miratuar, Vendimin nr. 8/2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, si dhe Udhëzimin nr. 41/2014 “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Republika Popullore e Kinës nuk bën pjesë ndër shtetet e listuara në Vendimin e mësipërm si vend me siguri të mjaftueshme për mbrojtjen e të dhënave personale.

Pavarësisht këtij fakti, Udhëzimi nr. 41/2014 parashikon rastet sipas të cilëve transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, mund të realizohet pa autorizim të Komisionerit, në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale dhe transferimi i parashikuar në këtë Marrëveshje mund të klasifikohet ndër kategoritë e parashikuara nga ky Udhëzim.

Në kushtet kur palët nënshkruese apo njëra prej tyre nuk kanë miratuar një ligj të posaçëm në këtë fushë, nuk kanë autoritet të pavarur për mbrojtjen e të dhënave personale, nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje duhet kushtëzuar me përfshirjen në përmbajtje të saj të një dispozite të posaçme për përpunimin e të dhënave personale apo hartimin e një aneksi si pjesë integrale e Marrëveshjes ku të parashikohen kushtet dhe garancitë për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Më konkretisht, dispozita apo aneksi, duhet të parashikojnë:

- (i) qëllimin specifik të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale,
- (ii) sasinë e të dhënave të nevojshme për arritjen e qëllimit të marrëveshjes,
- (iii) zbatimin e masave të sigurisë gjatë përpunimit,
- (iv) rastet e përhapjes së të dhënave shoqëruar me arsyet përkatëse,
- (v) veprimet që do të duhet të kryhen për përditësimin e të dhënave,
- (vi) korrigjimin e tyre,
- (vii) koha e ruajtjes së të dhënave,
- (viii) autoriteti kompetent për shkatërrimin e të dhënave,
- (ix) personat e autorizuar që do të aksesojnë të dhënat,
- (x) masat e marra për mbrojtjen me efektivitet të të dhënave të marra ndaj aksesit të paautorizuar etj. si dhe njoftimin e autoritetit dërgues për kryerjen e këtyre veprimeve.

Me përfshirjen në marrëveshje të parashikimeve të sugjeruara më sipër, Marrëveshja plotëson kushtet ligjore për përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale dhe si e tillë ajo vlerësohet e hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

